



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 282/22
Date: Datum. 28.07.22

PRISHTINË - PRIŠTINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Psh. nr. 282/22

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, nenin 4 paragrafi b) i “Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimin të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave”, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020, pas shqyrtimit të ankesës së OE “Avokatura Istrefi” me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim për nevojat e komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-22-6139-2-2-5, iniciuar nga AK- Komuna e Prishtinës, Kryesuesi i Sekretariatit të Organit Shqyrtues të Prokurimit z. Ardian Behra me datën: 27 korrik 2022, mori këtë:

VENDIM

- I. **Hedhet si e jashtëafatshme**, ankesa e OE “Avokatura Istrefi” me seli në Prishtinë, me nr. të protokollit 282/22, e datës 21 korrik 2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim për nevojat e komunës së Prishtinës” me numër të prokurimit 616-22-6139-2-2-5, iniciuar nga AK- Komuna e Prishtinës.

- II. I LEJOHET,** autoritetit kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj më tutje, me procedurat e prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim për nevojat e komunës së Prishtinës” me numër te prokurimit 616-22-6139-2-2-5.
- III.** Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores të Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën iu bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Organi Shqyrtues i Prokurimit, në sistemin elektronik me datë 21 korrik 2022, ka pranuar ankesë nga OE “Avokatura Istrefi” me seli në Prishtinë, ankesa ndërlidhet me aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim për nevojat e komunës së Prishtinës” me numër te prokurimit 616-22-6139-2-2-5, iniciuar nga AK- Komuna e Prishtinës.

Autoriteti kontraktues ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-se dhe letrën standarde me dt. 08. 07. 2022. OE ”Avokatura Istrefi shpk” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim me datën 15. 07. 2022, ne ditën e 7-te kalendarike.

AK-KK Prishtinë nuk ka publikuar vendim ne kërkesë për rishqyrtim duke sqaruar përmes email-it te dt. 25.07.2022 citat: “AK nuk i ka kthyer përgjigje ne kërkesë për rishqyrtim OE-se me faktin se ankuesi në këtë rast nuk ka qene pjese e këtij prokurimi”.

AK- KK Prishtinë me dt.18. 07. 2022 e publikon njoftimin për nënshkrim te kontratës.

Me datën 21. 07. 2022 nga operatori ekonomik “Avokatura Istrefi” me seli në Prishtinë është parashtruar ankesë për aktivitetin e prokurimit me titull: “Shërbime të veçanta kontraktuese për përfaqësim për nevojat e komunës së Prishtinës” me numër te prokurimit 616-22-6139-2-2-5.

Pra, në pajtim me nenin 108/A të LPP-së dhe sipas nenit 4 të Rregullave për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim pranë autoritetit kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera të tarifave kërkesa për rishqyrtim e OE ankues është parashtruar me dt.15. 07. 2022 ne ditën e 7 kalendarike dhe jo brenda 5 ditëve ashtu siç është paraparë në nenin 4, pika b) Kurdo qe kërkesa për rishqyrtim ka te beje me vendimin për dhënie të një kontratë ose te një konkursi te projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit te projektimit që i është dërguar ankuesit.

Duke u nisur nga sqarimet e dhëna si më lartë, OSHP konstaton se ankesa e parashtruar nga OE “Avokatura Istrefi” me seli në Prishtinë, hedhet si e jashtë afatshme sepse ankuesi ka parashtruar ankesë në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së si dhe nenin 4 të Rregullave të paraqitjes së Kërkesës për Rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, parashtrimit të ankesave pranë OSHP-së, dhe vlera e tarifave të ankesave, andaj e njëjta nuk hyn në shqyrtim nga OSHP.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – Komuna e Prishtinës

1x1 OE-“Avokatura Istrefi” me seli në Prishtinë

1x1 Arhivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së

